

VENDIM
Nr. 57, datë 29.1.2020

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE
TË TIRANËS SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË
FUSHËN E SPORTIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Universiteti i Sporteve të Tiranës (në vijim “UST”) është institucion publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, shkencor e sportiv, i krijuar me vendimin nr. 123, datë 17.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, të cilit i jepet status i veçantë.

2. Statusi i veçantë i dhënë për UST-në konsiston në trajtimin e veçantë të personelit akademik e administrativ, si dhe të programeve të studimit sipas legjislacionit në fuqi.

3. UST-ja është përgjegjëse për ofrimin e të gjitha programeve të studimit me kohë të plotë, programe studimi me karakter profesional, programe studimi në të tria ciklet e studimit, në fushën e edukimit fizik e sporteve, aktivitetit fizik për shëndet, rekreacionit e rehabilitimit, miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. UST-ja ka për mision:

- a) formimin universitar të studentëve e të specialistëve në të tria ciklet e studimeve;
- b) kualifikimin e punonjësve akademikë e shkencorë në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe të sporteve, të veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;
- c) nxitjen e kërkimeve e të studimeve në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;
- ç) thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistëve të lartë në fushën e veprimtarisë fizike, rekreacionit dhe turizmit, rehabilitimit, si dhe të mësuesisë në profilet e edukimit fizik dhe edukimit shëndetësor;

d) ofrimin e shërbimeve për të tretët dhe konsulenca në fushat e edukimit fizik, të atij shëndetësor dhe të sporteve, veprimtarisë fizike, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit.

5. UST-ja përfaqëson një strukturë të integruar dhe përbëhet nga njësi kryesore dhe institute kërkimore-shkencore.

6. UST-ja, si institucion i arsimit të lartë, që zhvillon veprimtari akademike në fushën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik e shëndetësor, të sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit, gëzon status të veçantë lidhur me:

a) organizimin e programeve të studimeve në cikle studimi që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave sipas rastit. Programet e studimeve në UST hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik. Senati shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofrojnë njësitë e universitetit para fillimit të aplikimeve për pranime në universitet. Studimet universitare organizohen, si më poshtë vijon:

- i. studime të ciklit të parë “Bachelor”;
- ii. studime të ciklit të dytë “Master i shkencave” ose “Master profesional”;
- iii. studime të ciklit të tretë për gradën shkencore “Doktor”;
- iv. studime specializuese afatgjata;
- v. studime të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”;
- vi. programe të formimit të vazhduar/afatshkurtër për fushat e edukimit fizik e shëndetësor, të sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;
- vii. programe studimi me karakter profesional;

b) ofrimin e procesit promovues, vlerësimin konkurrues dhe përfundimin me sukses të programit përkatës të formimit/trajnimit;

c) veprimtarinë profesionale dhe sportive të realizuar nga personeli akademik i saj, konvertuar në veprimtari shkencore, që shërbejnë për të vlerësuar performancën akademike vjetore sipas përcaktimeve në statutin e UST-së, konvertime, të cilat nuk janë të vlefshme për fitimin e gradave shkencore apo titujve akademikë;

ç) punësimin e personelit akademik me kohë të plotë, sipas kriterëve të përcaktuara nga njësia bazë e të miratuara nga rektori, veç arritjeve akademike e shkencore të kandidatit, si dhe vlerësimin e karrierës profesionale sportive sipas përcaktimeve në statutin e UST-së;

d) mbështetjen, promovimin dhe pranimin për studime të sportistëve me statusin e nivelit të lartë sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi;

dh) të drejtën për të realizuar marrëveshje bashkëpunimi me universitete, akademi, kolegje të larta, institucione shkencore, agjenci dhe shoqata brenda e jashtë vendit, për shkëmbim përvoja dhe bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor për ngritjen e komisioneve të përhershme për promovimin e personelit akademik, si dhe për kualifikimin e personelit akademik/administrativ e të studentëve, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Niveli i bashkëpunimit përcaktohet në marrëveshjet përkatëse të lidhura ndërmjet institucioneve;

e) të drejtën e hartimit e zhvillimin e programeve të studimeve dhe të projekteve të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik, atij shëndetësor dhe sporteve, të veprimtarisë fizike, rekreacionit, turizmit sportiv e rehabilitimit;

ë) hartimin e kriterëve dhe testeve fizike të pranimit me konkurrim të kandidatëve për studentë në UST.

7. Vetëm për efekt të mësimdhënies si veprimtari akademike në UST, pa gëzuar të drejta të tjera, figurat e shquara dhe me një veprimtari të spikatur sportive brenda dhe jashtë vendit ftohen të japin kontributin e tyre në mësimdhënie për lëndët speciale, si personel akademik, në rast se plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë kryer studimet në arsimin e lartë në profilin përkatës për të cilin kërkojnë të punësohen e të zotërojnë diplomën “Master i shkencave”. Në rastet kur studimet në fushën e sporteve në profilin përkatës, për të cilin kërkojnë të punësohen, janë kryer në një IAL jashtë vendit, duhet të kenë të njohur e të njësuar diplomën përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të kenë një veprimtari sportive të spikatur, veprimtari me interes kombëtar, e cila të jetë e dokumentuar me botime në katalogët/agjendat përkatëse.

8. Vlerësimi i kërkesave për njësimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, vetëm për efekt të mësimdhënies së personelit akademik që do të ftohet të japë kontributin e tij në mësimdhënie, bëhet nga komisioni “ad-hoc”, i ngritur me vendim të Senatit Akademik të UST-së. Rektori i UST-së, në bazë të pozicioneve të lira të miratuara nga Senati Akademik dhe të listës së kandidatëve të përzgjedhur nga komisioni “ad-hoc”, lidh kontratat njëvjeçare të punës.

9. Statuti i UST-së miratohet me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, bazuar edhe në statusin e veçantë të dhënë me këtë vendim.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe